

**« 2 T » SH.P.K**

**RAPORTI I DHËNIES SË SIGURISË  
I AUDITUESIT LIGJOR**

**Mbi verifikimin e fitimeve të mbartura  
Për qëllim të zmadhimit të kapitalit themeltar të shoqërisë  
sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve nr.2, datë 27/09/2023**

## **RAPORT I DHËNIES SË SIGURISË I AUDITUESIT LIGJOR**

**Drejtuar: ASAMBLEË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË  
“ 2 T ” sh.p.k**

### **Qëllimi i Angazhimit:**

Asambleja e ortakëve të shoqërisë me vendimin nr.2, datë 27 Shtator 2023, na ka angazhuar si auditues ligjor për të verifikuar dhe për të dhënë siguri të arsyeshme në lidhje me saktësinë e fitimeve të mbartura dhe të vitit ushtrimor sipas seksionit të kapitaleve të veta të Pasqyrave Financiare të shoqërisë deri dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022, për qëllim zmadhimin e kapitalit të shoqërisë “ 2 T ” sh.p.k

### **Kriteret**

Për të përmbushur këtë angazhimin ne jemi bazuar në:

- Kapitalin e regjistruar të shoqërisë “ 2 T ” sh.p.k dhe strukturën e kuotave në përputhje me të dhënat e shoqërisë sipas “Ekstraktit të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit të Qendrës Kombëtare të Biznesit dt 2 Tetor 2023;
- Vendimin e Asamblese së Ortakëve nr.2, datë 27 Shtator 2023 (bashkëngjitur këtij Raporti)
- Pasqyrat Financiare të shoqërisë për priudhen deri në 31.12.2022;
- “Pasqyra e fitimeve që do të përdoren për rritjen e kapitalit” dhe “Vlerës së kuotës dhe % e zotërimit të secilit ortak” (bashkëngjitur si Aneksi 1);
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, Ligjin Nr.25/2018 date 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”;
- Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

### **Përgjegjësia e Drejtimit**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të të gjitha pasqyrave për qëllim të zmadhimit të kapitalit (në vijim pasqyrave financiare), përgatitjen e akteve juridike dhe të zbatimit të procedurave ligjore e statutore të nevojshme për zmadhimin e kapitalit në përputhje me kriteret e sipërpërmendura.

Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve, zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabël dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat financiare.

Drejtimi është përgjegjës për respektimin e të drejtave të ortakëve dhe kryerjen e llogaritjes së drejtë të kuotave dhe vlerës së tyre që i takojnë ortakëve të shoqërisë në momentin e zmadhimit të kapitalit dhe për respektimin e modaliteteve ligjore dhe statutore për thirrjen e asamblesë me rend dite zmadhimin e kapitalit themeltar.

### **Përgjegjësia jonë**

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në procedurat e kryera, të shprehim një opinion për shumën e fitimeve të pasqyruara në Pasqyrat Financiare të shoqërisë “ 2 T ” sh.p.k dhe nëse shumata e fitimeve të përcaktuara për rritjen e kapitalit është e saktë dhe përputhet me kontabilitetin.

Ne e kryem auditimin në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Dhënies së Sigurisë (SNAS 3000) "Angazhime të dhënies së Sigurisë që ndryshojnë nga Auditimet apo rishikimet e Informacioneve Financiare Historike" dhe standardet e tjera që lidhen me çështjen në fjalë. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë procedurat e nevojshme për të dhënë një nivel sigurie të arsyeshëm që informacionet e përgatitura nga drejtimi i shoqërisë janë të vërteta dhe të sinqerta në të gjitha aspektet materiale dhe në aspektin e tyre matematikor, që fitimet e realizuara në vitin ushtrimor dhe në periudhat kontabël të mëparshme të mund të përdoren për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### Procedurat e kryera nga ana jonë për këtë angazhim përfshijnë:

Bazuar në dokumentacionin që na është vënë në dispozicion nga Drejtimi i shoqërisë "2T" sh.p.k, procedurat e kryera nga ana jonë përfshijnë:

1. Verifikimin e fitimeve të shoqërisë të pasqyruara në pasqyrën e Kapitaleve të Veta dhe përputhshmërinë e tyre me ato të paraqitura në Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2022.
2. Verifikimin e "Pasqyrës së kapitaleve të veta dhe fitimeve" që do të përdoren për rritjen e kapitalit dhe "Pasqyrës së vlerës së kuotes dhe % së zotimit të kapitalit të sejcilit ortak".

#### Konkluzioni:

1. Bazuar në procedurat e kryera, shuma e kapitaleve të veta sipas Pasqyrave Financiare të mbyllura më 31.12.2022 janë si më poshtë:

	<u>31.12.2022</u>
Kapitali i nënshkruar	600,000,000
Rezerva Ligjore	66,674,550
Rezerva të tjera	946,630,267
Fitime te mbartura	37,766,600
Rezultati i vitit ushtrimor	133,839,216
<b>Shuma e Kapitaleve të veta</b>	<b><u>1,784,910,633</u></b>

Këto shuma rakordojnë me llogaritë përkatëse dhe dokumentacionin mbështetës që ne verifikuam. Pasqyra e kapitaleve të veta si më sipër, për qëllim të zmadhimit të kapitalit themeltar të shoqërisë, jep një pasqyrim të sinqertë dhe të vërtetë të gjendjeve të Kapitaleve të Veta për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022.

Shuma e rezervave, fitimeve të vitit ushtrimor që janë pasqyruar në Pasqyrat Financiare të shoqërisë mund të përdoren për të realizuar shtesën e kapitalit të shoqërisë sipas tabelës në vijim:

Rezerva të tjera	946,630,267
Fitime te mbartura	37,766,600
Rezultati i vitit ushtrimor	133,839,216
<b>Shuma e Kapitaleve të veta</b>	<b><u>1,118,236,083</u></b>



Shuma e rezervave dhe e fitimeve të vitit ushtrimor 2022, prej 1,000,000,000 lekë, e përcaktuar në vendimin nr.2, datë 27/09/2023 për rritjen e kapitalit themeltar është në përputhje me shumën e fitimeve të shoqërisë të pasqyruara në pasqyrat e saj financiare dhe me vendim të asamblesë së ortakëve të shoqërisë, dhe kjo shumë mund të përdoret lirisht për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë.

2. "Pasqyra e kapitaleve te veta dhe fitimeve" që do të përdoren për rritjen e kapitalit dhe "Pasqyra e vleres së kuotes dhe % e zotërimit të sejcilit ortak" mbas rritjes së kapitalit me fitimet e vitit dhe të mbartura, të përgatitur nga shoqëria me datë 28 Shtator 2023, sipas Aneksit 1 dhe shënimet shpjeguese bashkëlidhur këtij raporti, pasqyron me vërtetësi shumat e kontributeve të ortakëve të shoqërisë dhe përputhet me vlerat e derdhjeve si më sipër, si edhe me fitimet respektive të sejcilit ortak.


Këto pasqyra paraqesin me korrektësi nga ana matematikore shumën e kapitalit që do të përfitoje secili ortak mbas miratimit të rritjes së kapitalit nga Asambleja e Ortakëve të shoqërisë " 2 T " sh.p.k sipas aneksit Nr.1 bashkëlidhur.

- Kapitali themeltar i shoqërisë nga 600,000,000 lekë, rritet edhe me 1,000,000,000 lekë dhe bëhet 1,600,000,000 lekë.
- Përqindja e zotërimit të kapitalit dhe vlera e secilës kuotë mbas rritjes së kapitalit do të bëhet si më poshtë:

Ortaku	Nr. I kuotave	% në kapital	Vlera në lekë e kuotës
Dritan Troksi	1	50%	800,000,000
Artan Sako	1	50%	800,000,000
<b>Shuma</b>	<b>2</b>	<b>100.00%</b>	<b>1,600,000,000</b>

Me respekt

Auditues Ligjor

A blue circular stamp with the text "D.D. AUDIT sh.p.k" at the top and "TIRANA - ALBANIA" at the bottom. A handwritten signature in blue ink is written over the stamp.

Tiranë, më 2 Tetor 2023

"2 T" sh.p.k

Pasqyra e kapitaleve te veta per fitimet do te perdoren per rritjen e kapitalit.

Vlera e kuotes dhe % e zotimit te sejcilit ortak mbas rritjes me fitimet e vitit dhe te mbartura .

Kapitalet e veta 31.12.2020	Vlera	Shumat e fitimeve qe do te perdoren per rritjen e kapitalit	Vlera
Kapitali i Nenshkruar	600,000,000	1,000,000,000	1,600,000,000
Rezerva statutore	-	-	-
Rezervat Ligjore	66,674,550	6,691,960	73,366,510
Rezervat Te tjera	946,630,267	(872,852,744)	73,777,523
Fitime te pashperndara	37,766,600	-	37,766,600
Rezultati neto vitit 2022	133,839,216	(133,839,216)	-
<b>Shuma</b>	<b>1,784,910,633</b>		<b>1,784,910,633</b>

Shuma qe do te perdoret per zmadhimin e Kapitalit	Vlera	Vlera	Vlera
		1,000,000,000	
<b>Totali</b>	<b>600,000,000</b>	<b>1,000,000,000</b>	<b>1,600,000,000</b>

Logaritjet per zmadhimin e Kapitalit Themeltar te Shoqerise

	Kapitali para	Kapitali pas zmadhimit	
Kapitali Themeltar ekzistues	= 600,000,000	-	
<b>Shtesa e Kapitalit nga fitimet</b>	<b>+</b>		
Dritan Troksi		500,000,000	
Artan Sako		500,000,000	
<b>Kapitali i Shoqerise pas shteses</b>	<b>= 600,000,000</b>	<b>1,600,000,000</b>	
<b>Numri i kuotave ne kapit themeltar</b>	<b>= 2</b>	<b>2</b>	
	<b>Nr i kuotave</b>	<b>Vlera</b>	<b>Ne % mbi kapitalin</b>
Dritan Troksi	1	800,000,000	50%
Artan Sako	1	800,000,000	50%

Tiranë ,më 28 Shtator 2023

Administratori i shoqerise

Artan Sako

*Artan Sako*

